



19 tetor 2015

## AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

### **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme refuzon si të pabazuar padinë e ish blerësit të “MIM Golesh”**

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka pranuar Aktvendimin AC-I-15-0145-A0001 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK). Me këtë aktvendim i është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit si dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS C-I-14-0022, i datës 27.05.2015

Ish blerësi ishte ankuar edhe më parë në Kolegjin e Specializuar, duke e kundërshtuar vendimin e AKP-së për tërheqje të aksioneve dhe për vendosjen e kësaj ndërmarrje nën administrimin e drejtpërdrejt të AKP-së, ndërkaq kishte kërkuar pezullimin e këtyre vendimeve. Mirëpo ky Kolegj i Apelit e kishte vlerësuar si të pabazuar kërkesën e ish blerësit për masë të përkohshme, duke i dhënë kështu të drejtë AKP-së në vendimet e ndërmarrja.

Aktvendimi i lëshuar tani nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për refuzim të ankesës se ish blerësit-paditësit është përfundimtar, pasi që ky Kolegj është instanca përfundimtare gjyqësore lidhur me ndërmarrjet shoqërore përkatësisht AKP-në.

Aktgjykimi thekson se vendimet e atakuara të marra nga AKP-ja janë të bazuara në ligj dhe se vendimet e AKP-së për të tërhequr aksionet dhe rimarrë kontrollin mbi kompaninë janë lëshuar në përputhje me rregullat procedurale në fuqi.

## FUND